



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPESIMIT TE PRONAVE
ZYRA RAJONALE PER KTHIMIN DHE KOMPESIMIN E PRONAVE
QARKU DURRES

Adresa: Sheshi "LIRIA" Durres Shqipëri

Tel. ++355 52 37461/2, Fax ++355 52 37461/2

Nr. 58/32 Prot.

Durrës, më 01.01.2008

VENDIM

Nr. 384, date 01.01.2008

PER NJOHJEN E SE DREJTES SE PRONESISE, KTHIMIN DHE/OSE KOMPESIMIN E SAJ.

Sot me date 01.01.2008, ne mbeshtetje te pikes 2, te nenit 16, te ligjit nr. 9236, date 29.07.2004, "Per kthimin dhe kompesimin e prones", te ndryshuar, te Vendimit nr. 566, date 23.08.2006, te Keshillit te Ministrave, ne cilesine e Drejtorit te Zyres Rajonale te Qarkut Durres, mora ne shqyrtim kerkesen me Nr. 58/5 date 25.06.2007, dhe detyrat e Vendimit te AKKP Tirane Nr. 258 date 18.09.2007 e bere nga:

Kerkues: Trashegimtarete e subjekteve pretendues si te shp ronesuara: Jorgji Vevecka; Sofia Kolea; Konstadin Mima; Evdhoqes Goxhomani; Ariadhni Konomi bazuar ne deshmite e trashegimiseleshuar nga Noteria Tirane nr. 704 date 16.07.1993, vendimet e gjykates Tirane nr. 2049 date 31.05.2002 e Nr. 5220 date 03.07.2007, vendimi i gjykates Berat nr. 975 date 11.10.2005 dhe vendimet e gjykates Vlore nr 1134 date 23.06.2006 e nr. 1105 date 17.06.2005, me perfaqesues ligjor Z. Mikel Pepa dhe Z. Vasillaq Guxhumani te caktuar me prokurat e posacme nr. 262 rep, nr. 158 kol date 08.02.1997, nr. 4290 rep date 01.11.1995 dhe nr. 3203 rep, nr. 1793 kol date 31.10.1995.

Me objekt: Njohjen, kthimin ose kompesimin e prones me 1.575.900 m², pjese e prones se quajtur "Cifligut Rrushkull e Cifligu i Ri" me sipërfaqe (cifligu) 2943 ha e ndodhur në fshatin Hamallaj (sektor) me keto kufizime: Veriu - Qorralinjte, Fuat bej dhe Zija bej Toptani; Jugu - Shoqeria "EIA" dhe lumi Erzen; Lindje - Qani Hanem dhe Fuat bej Toptani; Perendimi - deti,

481

Bazuar në Nenet 2, 6 dhe 16 të ligjit 9235, date 29.07.2004, "Per kthimin dhe kompesimi pronave" të ndryshuar, pika 11, e VKM nr.566, date 23.08.2006, V.K.M. nr.747, date 09.10.2006, pika II dhe III.

Nga shqyrtimi i kerkeses se trashëgimtareve te subjekteve pretendues si te shpronësuar Jorgji Vevecka; Sofia Kolea; Konstadin Mima; Evdhoqes Goxhomani; Ariadhni Konon dokumentacionit bashkelidhur saj, materialeve shkresore te ndodhura ne dosjen nr 58 pr date 05.04.2007, qe ka lidhje me dosjen nr.97 e nr. 72 prot date 08.06.2006, qe ka lidhje r dosjen nr.2 Penellopi Samares, si dhe korrespondencave te krijuara me Z.V.R.P.P-ne Durr me shkresat tona nr.58/8 e 58/10 prot date 26.06.2007, dhe pergjigjies se tyre me shkresen n 1316/1 prot date 30.06.2007 dhe me Drejtorine e Sherbimit Pyjor Durres me shkresen to Nr. 58/12 prot date 06.07.2007 dhe pergjigjies se saj me shkresen Nr. 247/1 prot da 12.07.2007, ne zbatim te ligjit nr 9235, date 29.07.2004, "Per kthimin dhe kompesimin pronave" i ndryshuar.

VEREJ SE:

1. FAKTET MBI TE CILAT MBESHTEJTE KERKESA:

Nisur nga kerkesa e bere per njohjen kthimit ose kompesimin e prones se pretenduar me sipërfaqe 1.575.900 m² prej trashëgimtareve të subjekteve pretendues si të shpronësuar Jorgji Vevecka; Sofia Kolea; Konstadin Mima; Evdhoqes Goxhomani; Ariadhni Konon sipas deshmive te trashëgmive leshuar nga Noteria Tirane nr.704 date 16.07.1993, vendimet e gjykates Tirane nr.-2049 date 31.05.2002 e Nr. 5220 date 03.07.2007; vendimi i gjykates Bera nr. 975 date 11.10.2005, dhe vendimet e gjykates Vlore nr 1134 date 23.06.2006 e nr. 1105 date 17.06.2005, si dhe nga studimi i materialeve në dosjen nr 58 prot date 05.04.2007, qe ka lidhje me dosjen nr.97 e nr. 72 prot date 08.06.2006, qe ka lidhje me dosjen nr.2 Penellopi Samares rezulton se si dokument origjine pronesie kerkuesit kane paraqitur:

1. Vendim gjykate nr.1 date 03.01.1997 "percaktim sipërfaqe"
2. Planimetri e prones shk 1:10.000 2 kopje
3. Vendim gjykate nr 975 date 11.10.2005 (leshim deshmie trashgimnie).
4. Vertetim nga Dokumenti Hipotekor nr. 465 date 20.02.1940
5. Flet radhor per traskiptimet traskiptim kerkes-padie.
6. Prokure e posacme nr, 4290 rep, date 01.11.1995.
7. Procure e Posacme nr.262 rep, nr.158 kol date 08.02.1997
8. Vertetim Pronesie nga Ipoteka date 19.01.1994.
9. Vertetim Pronesie nga Ipoteka date 12.03.1993.
10. Vendimi i gjykates Durres nr. 52 date 02.03.1946.
11. Shkres e ZVRPP Durres Nr. 1805/1 prot date 30.08.2007 + bashkelidhur 19 flete nga radhori per traskiptimet.

492

12. Vendim gjykate nr. 1134 date 23.06.2005 (leshim deshmi trashgimnie)
13. Vendim gjykate nr. 2049 date 31.05.2002 (leshim deshmi trashgimnie)
14. Vendim gjykate nr. 1105 date 17.06.2005 (leshim deshmi trashgimnie)
15. Vendim Gjykate Nr. 5220 date 03.07.2007 (leshim deshmi trashgimnie)
16. Deshmi trashgimnie nr.704 date 16.07.1993 nga Noteria .
17. Deshmi trashgimnie nr.291 rep date 23.08.1993 nga Noteria.
18. Deshmi trashgimnie nr.10069 rep date 26.08.1993 nga Noteria..
19. Deshmi trashgimnie nr.2464 date 22.11.1993 nga Noteria.
20. Prokure e posacme nr.3203 rep, nr. 1793.kol date 31.10.1995
21. Urdheri Nr. 17 date 05.09.2007 i Drejtorit te ZRAKKP Qarku Durres.
22. Vendimi Nr. 258 date 18.09.2007 i Drejtorit te AKKP Tirane.
23. Planimetri e vjeter e prones sh 1:25.000
24. Planimetri e prones sh 1:2500 dy cope
25. Kerkese nr.58/1 prot date 05.06.2007
26. Relacion i Zyres Rajonale te AKKP Qarku Durres Nr. 58/20 prot date 30.08.2007
27. Korespodenca te ndryshme.

II. LIGJI I APLIKUESHEM.

1. Neni 2, E drejta e pronësisë, paragrafi 1 i ligjit 9235 date.29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e prones” i ndryshuar.
2. Neni 6, Njohja e së drejtës së pronësisë dhe kthimi i pronës, paragrafi 1, 1/a, 1/b, i ligjit 9235 date.29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e prones” i ndryshuar.
4. Neni 45 i ligjit Nr 84 85 date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative ” te R.Sh.
3. Pika 11 e VKM nr.566 date 23.08.2006 ,
4. VKM nr.747 date 09.11.2006, pika II dhe III.
5. Neni 13 pika 4 e urdherit nr.51 date 02.02.2007.
6. Urdhat e brendshem nr. 226 date.12.3.2007, Nr. 16 date 25.08.2007 dhe Nr. 17 date 05.09.2007

III. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE.

Si dokumenta pronesie trashgimtare e subjekteve pretendues si te shpronësuar disponojne: a.) Nje vertetim nga dokumenti hipotekor me nr. 465 date 20.02.1940; b.) Nje flete nga radhori pronesie traskiptimet i Ipotekes traskiptim kerkes-padie; c.) Nje vertetim pronesie leshuar nga Ipoteka Durres date 12.03.1993; d.) Nje vertetim pronesie leshuar nga Ipoteka Durres date 19.01.1994; e.) Vendimi i Gjykes Durres Nr. 52 date 02.03.1946; f.) Vendim i gjykate Durres nr.1 date 03.01.1994 “percaktim siperfaqe”; h.) 19 fletet e traskiptimit te prones derguar prane zyres sone nga ZVRI Durres me shkresen Nr. 1805/1 prot date 30.08.2007.

Me anen e ketyre dokumentave trashgimtare e subjekteve te pretenduar si te shpronësuar kerkojne te vertetojne se: Maria (Lubica) Shallvari; Jorgji Vevecka; Sofia Kolea; Konstadin Mima; Evdhoq Goxhomani; Ariadhni Konomi. kane qene bashkepronar te nje siperfaqe toke prej 2943 ha, cifligj Rushkull me keto kufizime: Veriu – Qorralinjte, Fuat bej dhe Zija bej Toptani; Jugu – Shoqer

"EIA" dhe lumi Erzen; Lindje - Qani Hanem dhe Fuat bej Toptani; Perendimi - deti. Objekt i kërkesës nga trashgimtarët e subjekteve pretendues si të shpronësuar është vetëm një sipërfaqe 1.575.900 m² e këtij cifligu me kufij: Veriu - Qoralinjtë dhe prona e vet; Perendim - Deti; Jug Lindje - prona e vet.


Dokumentacioni i paraqitur që vërteton pronësinë e subjekteve pretendues si të shpronësuar është ligjshëm pasi është lëshuar nga institucione shtetërore. Kjo bazuar në V.K.M. nr 747 datë 09.11.2006, seksioni I, pika 3/a, germa i e vi.

2.) Trashgimtarët e subjekteve pretendues si të shpronësuar kanë paraqitur: a.) hartën e vjetër të pozicionimit të pronës sh 1:10.000, punuar nga topograf i licensuar; b.) Situacionin e Cifligut të Rrushkull (harte e vjetër punuar në italisht); c.) Hartë sipas sistemit të kadastrës me sh 1:10.000 duke e pozicionuar pronën sipas kufijve të origjinës. Ata kanë bërë edhe pozicionimin sipas kufijve të sistemit aktual të Z.V.R.P.P Durres sh 1:2500, duke e pozicionuar pronën sipas këtij sistemit, prona e pretenduar ndodhet në fshatin Hamallaj (sektor) në ZK 1925 me indeks harte K- 34-1 (144-B, 129-A, 129-B) me këto kufij: Veriu - Pas. Nr. 20/1, 21/9; Jugu - vija ndarë e midis fsh. Rrushkull-Hamallaj (sektor); Perendim - deti; Lindje - pas.nr. 21/9, 21/10, 134.

Planimetritë e përdorura në pozicionimin e pronës janë të ligjshme pasi kanë dalë në institucionet e percaktuara në V.K.M. nr 747, datë 9.11.2006, seksioni I, 3/b, ii, 3/c,

3. Bazuar në deshmite e trashëgimise nga Noteria Tirane nr.704 date 16.07.1993, vendimet e gjykatës Tirane nr. 2049 date 31.05.2002 e Nr. 5220 date 03.07.2007, vendimi i gjykatës Berat nr. 975 date 11.10.2005, dhe vendimet e gjykatës Vlorë nr 1134 date 23.06.2006 e nr. 1105 date 17.06.2005, trashëgimtarët e trashëgimtarëve të pretenduar si bashkepronar janë: a.) Bashkepronarët pretenduesin si bashkepronar Jorgji Vevecken trashëgimtarët janë Pinellopi Samara e Ana Mitra që gezojnë secila nga 1/2 pjesë të pasurisë së tij. Pjesa pretenduese e tij është 25.2/105 pjesë në pasuri mylk dhe 3.06/11.97 pjesë në pasuri toke, mbi të gjithë pronën; b.) Per pretenduesin bashkepronarë Konstantin Mima trashëgimtarët janë: Polikseni Mima që gezon 2/8 e pjesë të pasurisë së tij, Eleni Mima që gezon 3/8 pjesë të pasurisë së tij dhe Marjeta, Ravik e Emi Mima që gezojnë secili nga 1/8 pjesë të pasurisë së tij. Pjesa pretenduese e tij është 11.2/105 pjesë në pasuri mylk dhe 1.06/11.97 pjesë në pasuri toke, mbi të gjithë pronën; c.) Per pretenduesin si bashkepronarë Evdhoqes Goxhomani trashëgimtarët janë Drita e Vasillaq Goxhomani që trashgojnë secili nga 1/2 pjesë të pasurisë së saj. Pjesa pretenduese e saj është 11.2/105 pjesë në pasuri mylk dhe 1.06/11.97 pjesë në pasuri toke, mbi të gjithë pronën; d.) Per pretenduesin si bashkepronarë Ariadhni Kononi trashëgimtarët janë: Lika Pjero (Konomi) Andromaqi Konomi, Fotaq Konomi, Afroviti Konomi, Agallaia Konomi dhe Nikollaq Konomi që gezojnë secili 1/6 pjesë të pasurisë së saj. Pjesa pretenduese e saj është 11.2/105 pjesë në pasuri mylk dhe 1.06/11.97 pjesë në pasuri toke, mbi të gjithë pronën; e.) Per pretenduesin si bashkepronarë Sofia Kolea trashëgimtarët janë: Vasillaq Goxhomani, Drita Goxhomani, Pinellopi Samara e Ana Mitra që gezojnë secili nga 1/2 e 1/4 pjesë të pasurisë së saj; Lika Pjero (Konomi) Andromaqi Konomi, Fotaq Konomi, Afroviti Konomi, Agallaia Konomi dhe Nikollaq Konomi që gezojnë secili nga 1/6 e 1/4 pjesë të pasurisë së saj; Polikseni Mima që gezon 2/8 e 1/4 pjesë të pasurisë së saj, Eleni Mima që gezon 3/8 e 1/4 pjesë të pasurisë së saj dhe Marjeta, Ravik e Emi Mima që gezojnë secili nga 1/8 e 1/4 pjesë të pasurisë së saj. Pjesa pretenduese e saj është 18.2/105 pjesë në pasuri mylk dhe 3.06/11.97 pjesë në pasuri tokë.

484 =



mbi të gjithë pronën. f.) Sipas kërkesës së trashgimtareve pretendues si bashkpronarë bashkëpronarë Maria (Lubica) Shallvari e cila ka qene shtetase e huaj, nuk ka asnjë informacion prandaj pjesa e kësaj, ata kërkojnë që të ngelet në emer të saj. Ajo trashëgon 28/105 pjesë pasuri pasurish të 2.67/11.97 pjesë në pasuri toke, mbi të gjithë pronën.

Deshmit e trashëgimnise janë akte juridike të ligjshme të leshuara nga gjykata dhe brenda kërkesave të ligjit.

4. Pjesa me e madhe e ketyre trashgimtareve kane caktuar Z Mikel Pepa dhe Vasillaq Guxhumari perfaqesues ligjor te tyre me prokurat nr. 262 rep, nr. 158 kol date 08.02.1997, nr. 4290 rep 01.11.1995 dhe nr. 3203 rep, nr. 1793 kol date 31.10.1995.

Prokurat janë të ligjshme dhe në të janë perfaqesuar pjesa me e madhe e trashëgimtarëve pretendues që dalin nga deshmite e trashëgimnive.

IV. KONKLuzioni.

Nga studimi i kërkesës Nr. 58/5 prot date 25.06.2007, dokumentacionit bashkelidhur saj si dhe të grumbulluar nga vet zyra jone, rezultojnë që zyra jone mbeshtetur në udhëzimet e dhëna nga AKKP Tirane me vendimin e saj nr. 258 date 18.09.2007 Zyra Rajonale e AKKP Qarku Durres duhet të zgjidhë këto probleme:

- a.) A plotëson të gjitha kërkesat e ligjit 9235 date 29.07.2004 i ndryshuar dhe akteve nenligjore në zbatim të tij dokumentacioni i pronës së pretenduar?
- b.) A legjitimohen si pale në këtë proces administrativ trashgimtarët e subjekteve pretendues duke përjashtuar subjektin Maria (Lubica) Shallvari Lampo?

Në lidhje me pyetjen e parë rezultojnë se nga studimi i dosjes nr 58 prot date 05.04.2007, që lidhje me dosjen nr.97 e nr. 72 prot date 08.06.2006, që ka lidhje me dosjen nr.2 Penellopi Samari veme re se trashgimtarët e subjekteve pretenduese si të shpronësuar kane paraqitur si dokumente pronesie: a.) Një vertetim nga dokumenti hipotekor me nr. 465 date 20.02.1940; b.) Një fletë në radhori për traskiptimet i Ipotekës traskiptim kërkes-padie; c.) Një vertetim pronesie leshuar nga Ipoteka Durres date 12.03.1993; d.) Një vertetim pronesie leshuar nga Ipoteka Durres date 19.01.1994; e.) Vendim i Gjykates Durres Nr. 52 date 02.03.1946; f.) Vendim i gjykates Durres nr date 03.01.1997 "percaktim sipërfaqe"; h.) 19 fletët e traskiptimit të pronës derguar pranë zyres sone nga ZVRPP Durres me shkresën Nr. 1805/1 prot date 30.08.2007.

Po kështu nga hetimi administrativ i realizuar rezultojnë se origjina e pronës është si mëposhtë: të gjithë prona ka qene në emer të Z.Miltiadh Shallvari dhe e ka origjinen në librin 10 të kadastrës së fshatit Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo faqe nr 21, 22, 23, 24 date 19.08.1919 dhe me numrat prej 31 deri në 56. Me pas në vitin 1940 është rezultuar i një testamenti të datës 08.05.1929 lene nga Z. Miltiadh Shallvari dhe vdekjes së testatorit të datës 12 ne date 17.05.1933, prona është traskiptuar në volumin 11 rep, me nr. Rendor. 527 faqe 32 vol 15 dosje artikull 117, në favor të Znj.Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo. Në 27 prill 1940 xviii, Znj. Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, e veja e Miltiadh Shallvarit, e ka dhënë me enfiteoz për 99 vjet pronën e quajtura Rrushkull e Ciflik i Ri në favor të shoqërisë anonime Ente Industria Attivita Agrarie shkurtimisht E.I.A.A.,. Në 29.05.1946 prona është traskiptuar në favor të shtetit shqiptar kundra shoqërisë anonime Ente Industria Attivita Agrarie shkurtimisht E.I.A.A dhe ku në këtë traskiptim saktësohet se prona është marrë me pajtim nga Znj.Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo.

48

Te dhenat me te detajuara ne lidhje me origjinen e prones jepen ne relacionin me Nr. 58/20 c 30.08.2007 qe ndodhet ne dosje. Nga sa me larte ne pergjigje te pyetjes se pare rezultoni dokumentacioni eshte i plote dhe konforme kerkesve te ligjit 9235 date 29.07.2004 i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.

Ne lidhje me deshtjen e dyte a legjitimohen trashegimtarët e subjekteve pretendues si pale ne kete proces sqarojme si me poshte:

Nga vlersimi i bere relacionit Nr. 58/20 prot date 30.08.2007 nen cilesin e Drejtorit te Z.R.A.K.K. Qarku Durres konstatoj se sic del edhe nga pershkrimi i bere ne relacion mbi rrjedhen dhe origjinen e prones rezulton te dalin keto dy probleme: 1.) E gjithë prona rezulton ne emer te Znj. Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe i eshte dhene me qera shoqeris "EIAA" ne vitin 1940 per 99 vje e me pas eshte sekuestruar nga shteti shqiptar ne 29.05.1946 kesaj shoqerie duke njohur marrjen me qera nga Znj. Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe pretenduesit ne asnje rast nuk figurojne pronar ose bashkepronar. 2.) Vendim i Gjykates Durres Nr. 52 date 02.03.1946 i cili ka konsideruar te pavlefshem testamentin e lene nga Z. Miltiadh Shallvari ne favor te Znj. Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe ka vendosur te njohe si bashkepronar Znj. Maria (Lubica) Shallvari; Jorgj. Vevecka; Znj. Sofia Kolea; Z. Konstadin Mima; Znj. Evdhoqes Goxhomani; Znj. Ariadhni Konomi, sipas pjeseve perkatese qe permban ky vendim nuk eshte traskiptuar ne regjistrat e hipotekes se asaj kohe e per pasoj nuk i ka sjell efektet e veta juridike.

Ne kushtet kur: a.) Pretenduesit nuk e kane poseduar pronen ne asnje moment (pasi prona eshte sekuestruar se fundi nga shteti shqoptare kundra E.I.A.A) dhe b.) Vendimi i Gjykates Durres Nr. 52 date 02.03.1946 nuk ka sjell asnje efekt per rregjistrimin e prones, duke sjell parashkrimin e se drejtes se kerkimit. Nga sa me larte vlersohet se kerkuesit bazuar ne nenin 45 te ligjit Nr 84 85 date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative" te R.Sh. nuk legjitimohen si pale ne procesin administrative.

Sic edhe u sqarua me larte ne perfundim te shqyrtimit administrativ konkludoi qe nuk duhet te njihet e drejta e pronesise trashgimtareve kerkues te subjekteve pretendues si te shpronesuara per pronen e pretenduar me siperfaqe prej 1.575.900 m², si kerkes ne kundersizim me ligjin Nr.9235 date 29.07.2004 i ndryshuar, dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij dhe rendit juridik ne fuqi.

Te dhenat me te detajuara ne lidhje me kete kerkes jepen ne Vlersimin Ligjor qe ndodhet ne dosje.

PER KETO ARSYE

Bazuar sa me siper dhe ne mbeshtetje te neneve 2, 6/1 dhe 16 te ligjit nr 9235, date 29.07.2004, "Per kthimin dhe kompesimin e prones", te ndryshuar, nen cilesine e Drejtorit te Zyres Rajonale te AKKP-se Qarku Durres.

VENDOSA:

a.) Te mos njohe te drejten e pronesise trashgimtareve te subjekteve pretendues si te shpronesuara Jorgji Vevecka; Znj. Sofia Kolea; Z. Konstadin Mima; Znj. Evdhoqes Goxhomani; Znj. Ariadhni

486

onomi te cilet dalin nga deshimit e trashgimive te dhena ne **piken 3** te ketij vendimi, per pro
e siperfaqe 575.900 m², e ndodhur ne fshatin Hamallaj (sektor) ne ZK 1925 me indeks harte
4-88-(144-B, 129-A, 129-B) me keto kufij: Veriu- Pas. Nr. 20/1, 21/9; Jugu- vija ndarse e fsh
rshkull; Perendim - deti; Lindje- pas.nr. 21/9, 21/10, 134, pasi keta trashgimtare nuk legjitmo
i pale ne procesin administrative per mangesit e dalura ne pjesen pershkurse te Vlersimit Ligjor
idodhet ne dosje.

- b.) Vendimi hartohet ne 6 (gjashte) kopje.
(2 kopje qendrojne ne protokollin e institucionit, 1 kopje i jepet menjehere kerkuesit nga zyra
protokollit, 1 kopje dergohet ne zyren Qendrore te A.K.K.P-se, 1 kopje dergohet ne Z.R.P.P, si d
1 kopje prane Avokatures se shtetit).
- c.) Kunder ketij vendimi mund te behet ankim brenda 30 diteve nga dita e njoftimit te tij, pran
Zyres Qendrore te Agjensise se Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane.

U shpall sot me date 04/01/2008

Drejtori i Zyrës Rajonale të Agjensise se Kthimit dhe Kompesimit të Pronave
Qarku DURRES

Ing. Klodi BENJA



Shenim: Ky vendim perben titull ekzekutiv nga data 24/09/2008

Drejtori i Zyrës Rajonale të AKKP-së, të Qarkut Durres Teodor Benja
 Zene ne fuqi i vendimit Nr 384 dt 04.01.2008 me
 Nr 1070 dt 27.09.2008 te AKKP Tirane

